



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:090340

Datë: 04.09.2024

Numri i dokumentit: 06116133

KF.nr.226/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit “British American Tobacco Kosovo” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810519316, dhe me seli në Graçanicë, Llapnasellë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ardian Rexha, Avokat nga Shoqëria “Deloitte Kosova” me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti 225,514.37 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Ardian Rexha Avokat, dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 26.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “British American Tobacco Kosovo” Sh.P.K., me seli në Graçanicë, Llapnasellë.
- II. ANULOHET vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.32/2021 i datës 12.03.2021.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit, “British American Tobacco Kosovo” Sh.P.K., me seli në Graçanicë, Llapnasellë, t’ia kthej mjete e paguara më tepër edhe atë në pjesën që i referohet TVSH-së për periudhën Maj 2016-Dhjetor 2017 në shumë prej 217,361.24 € (dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një euro e njëzet e katër cent), dhe në emër të ndëshkimeve dhe interesave shumë prej 8,153.13 € (tetë mijë e njëqindën e pesëdhjetë e tretë euro e trembëdhjetë cent) të gjitha këto në shumë prej 225,514.37 € (dyqindën e njëzet e pesë mijë e pesëqind e katërmëdhjetë euro e tridhjetë e shtatë cent), së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave

dhe ekonomisë në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 12.05.2021, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër vendimit nr.32/2021 të datës 12.03.2021, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia si e bazuar, të anulohet vendimi i të paditurës, dhe të detyrohet e paditura që paditësit ti rikthejë çdo pagesë të bërë, bazuar në njoftimin e vlerësimeve të bëra me Raport të Kontrollit. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor-kryesor përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se e kemi pranuar plotësimin e ekspertizës financiare për çka pajtohem në tërsi dhe nuk kemi vërejtje asnjë vërejtje shtesë. Në parashtresën për precizim të kërkesëpadi së paditësi ka kërkuar që të detyrohet e paditura t'ia kthejë paditësit shumën prej 217,361.24 euro, në emër të TVSH-së shtesë dhe mos njohjes së kreditimit të TVSH-së, për periudhën maj 2016-dhjetor 2017 dhe shumën prej 8,153.13 euro në emër të ndëshkimeve dhe interesave, apo shumën e përgjithshme prej 225,514.37 (dyqindën e njëzet e pesë mijë e pesëqind e katërmbëdhjetë euro e tredhjet e shtatë cent), të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga data e marrjes së vendimit të kontestuar e deri në pagesën përfundimtare. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar paditësit i takon e drejta e kreditimit të TVSH-së së zbritshme në transaksionet me shoqërinë amë, sepse ka kryer furnizime të tatueshme sipas nenit 20 paragrafi 1 të Ligjit për TVSH, me ç 'rast i takon e drejta e zbritjes së TVSH sipas nenit 36 paragrafi 2 të Ligjit për TVSH, si dhe një gjë e tillë është konfirmuar nga vet e paditura përmes Vendimit Shpjegues Individual, e që në përputhje me nenin 10 paragrafi 2 të Ligjit për ATK dhe procedurat ka karakter detyrues për tatimpaguesin dhe ATK-në, këtu palët ndërgjyqëse.

E paditura në përgjigje në padinë të datës 20.12.2021, i kundërshton pretendimet e paditësit në padi si të pa bazuara në ligj dhe fakte dhe vlerëson se vendimi i kundërshtuar ka mbështetje ligjore dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin tatimor të aplikueshmen në Republikën e Kosovës. Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e shqyrtimit gjyqësor - kryesor edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt i njëjti nuk ka prezantuar dhe me parashtresën e datës 22.08.2024, e

ka njoftuar gjykatën se nuk mund të prezantoj në këtë seancë dhe ka kërkuar që të veprohet konform nenit 38 paragrafi 5 të LKA-së. Ndërsa me parashtrësën e datës 09.07.2024 dhe atë të datës 22.08.2024 e ka kundërshtuar ekspertizën financiare të datës 30.04.2024 dhe plotësimin e saj, me arsyetim se lidhur me rekomandimet e saj është e pa bazë dhe e pa mbështetshme, sepse ekspertja në ekspertizë financiar përveç që i ka përshkruar pretendimet e palës paditëse dhe çështje e ngritura të ATK-së, nuk ka arritur të konstatoj asgjë lidhur me këtë rast. Tutje ka theksuar se paditësi me faturimet e shpenzimeve tek kompania amë, nuk ka bërë kurrfarë transaksione të tatueshme dhe për to nuk mund të zbritet TVSH-ja dhe konstatimi i ekspertës financiare se nga rishikimi i transaksioneve financiare dhe regjistrave bankare është konstatuar se ka pasur, shoqëria amë ka kryer për shërbimet e marruar për paditësin nuk qëndrojnë, sepse sqarimi i Departamentit të Kontrollit Tatimor dhe Departamentin e Tatimpaguesve të Mëdhenj i datës 07.07.2020, në pyetjen që i është drejtuar për trajtimin e kësaj çështje sqaron “këtu nuk kemi të bëjmë me furnizim të mallrave dhe shërbimeve në kuptim të nenit 3, të Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, respektivisht kërkesa për rimbursim të mjeteve nuk ka të bëjë me nenin 10 (Furnizimi i Mallrave), ose neni 14 (Furnizimi i Shërbimeve), të Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Konsiderojmë se vetëm në rastet e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve të përcaktuar në Ligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në mes personave të tatueshme, duhet të lëshohet fatura sipas nenit 45 të këtij Ligji. Gjykatës i ka propozuar që të mos ia fal besimin ekspertizës financiare, të refuzoj padinë e ushtruar nga paditësi, si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i ATK-ës nr.32/2021 i datës 12.03.2021.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës 26.08.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: Raporti i kontrollit i datës 09.12.2020, Njoftim vlerësimet për TVSH nga 04/2016 deri 12/2017, Ankesë e paditësit nr.32/2021 e datës 14.01.2021, Faturat: nr. 21, 20, 6/17, 22, Specifikacionet për faturat 20, 21, 22, Kontratë për shërbime në mes BAT Kosovë dhe BAT Angli, Vërtetimi tatimor i BAT WECT Agli, Mostër e dëshmisë së pagesë përmes llogarisë bankare, Kredit nota së bashku me tabelën e Excel, Kërkesë për vendim shpjegues individual datës 25.11.2016, Vendimi shpjegues individual i datë 22.12.2016, Përgjigje në padi e datë 20.11.2021, Sqarim nga e paditura nr.02/2020 e datës 07.07.2020, Vendimi nr. 32/2021 e datës 12.03.2021, Ekspertizë financiare e datës 30.04.2024 dhe plotësimi i ekspertizës i datës 05.08.2024, dokumentacioni shtesë i bashkangjitur me ekspertizë dhe Kundërshtimi i ekspertizës i datës 09.07.2024 dhe i datës 22.08.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjet në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë Kontest Tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, Raportit të kontrollit të datës 09.12.2020 , deklarimeve në padi dhe përgjigje në padi, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi i është nënshtruar kontrollit tatimor nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës, kontrolli ka përfshirë periudhat 12/2013-12/2017 për tatimin mbi vlerën e shtuar. Po ashtu nuk është kontestues fakti se paditësi pas pranimit të Njoftim Vlerësimeve të Drejtorisë Rajonale të ATK-së me datë 14.01.2021, ka paraqitur ankesë në Departamentin e Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila me datën 12.03.2021 ka marrë vendimin nr.32/2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin e ka refuzuar ankesën e paditësit, e kundër të cilit vendim paditësi me padinë e datës 12.05.2021, ka iniciuar konflikt administrativ në gjykatë.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankesave në shkallë të dytë e ka refuzuar ankesën e subjektit tatimor këtu paditësit, me arsyetim se Divizioni i Ankesave ka konstatuar se kontrolli, këtë vendosje-vlerësimin e ka mbështet në nenin 14, 15 dhe 19 të Ligjit të Ligjit nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe procedurat, ku paragrafi 2 i nenit 19 të Ligjit nr.03-L/222. Tutje ka shtuar se Divizioni i Ankesave pas analizës së dokumentacionit në dosje vërteton se tatimpaguesi nuk ka bërë faturim por ka bërë ri faturim të shpenzimeve nga BAT Kosova për BAT Londër, sipas legjislacionit në fuqi tatimpaguesi nuk ka argumentuar se transaksionet janë zhvilluar në mënyrë të pavarur me vete faktin se kemi të bëjmë me palë të lidhura si dhe faturimi nuk është në harmoni sipas dispozitave ligjore të Ligjit nr.05/L-037 për TVSH neni 44 dhe 45, që do të thotë se nuk i posedon elementet që duhet ti ketë një faturë. Sa i përket kontestit për mosnjohjen e kreditimit të TVSH-së, Divizioni i Ankesave pas analizës së dokumentacionit në dosje konstaton se kontrolli me të drejtë nuk i ka pranuar TVSH-në, e paguar bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit 05/L-037 për TVSH-në neni 36 paragrafi 2 i cili citon *“Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj, personi i tatueshëm mund të zbres nga obligimet e tij të TVSH-së, obligimin e TVSH-së, apo TVSH-në e paguar në lidhje me blerjet e mallrave apo shërbimeve,*

*këtu e tuje TVSH-ja e zbritshme, me kusht që si të ketë shfrytëzuar apo do të shfrytëzoj ato mallra ose shërbime për qëllime të transaksioneve të tij të tatueshme”.*

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.226/22 të datës 20.03.2024 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar Blerta Salihu Krasniqi, me detyrat përkatëse sikurse në dispozitiv.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën financiare të datës 30.04.2024 dhe plotësimi i ekspertizës i datës 05.08.2024, për detyrat e caktuara për ekspertizë është dhënë mendimi dhe konstatimi ashtu që për Konstatimin e vlerës së TVSH së zbritshme që nuk ishte njohur si e zbritshme nga faturat e blerjes për periudhën maj 2016-dhjetor 2017: është dhënë mendimi se: *Për periudhën maj 2016 - dhjetor 2017, është konstatuar se një shumë prej 217,361.24 EURO TVSH nuk është trajtuar si e zbritshme. Ndëshkimet dhe interesat e lidhura me këto mos-zbritje janë llogaritur në 9,416.17 EURO. Shuma prej 217,361.24 EURO është njohur si shpenzim shtesë në Deklarate Vjetore. Shuma 1,000.00 EURO ishte paguar për të deponuar Ankesën. 1. Ri-fakturimi dhe Faturimi i Drejtpërdrejtë: Një nga çështjet kryesore të ngritura nga ATK ishte nëse Paditësi ka kryer rifaturim të shpenzimeve në mënyrë të paautorizuar, e cila sipas ATK-se, nuk lejon kreditimin e TVSH-së së zbritshme. Sipas Nenit 44 dhe 45 të Ligjit për TVSH të Kosovës Nr. 05/L-037, çdo fature duhet të përmbajë një përshkrim të qartë të mallrave ose shërbimeve që janë duke u faturuar. Paditësi ka paraqitur prova që faturat përmbajnë disa detaje të tilla dhe argumenton se faturat janë jo vetëm për ri-faturime por për transaksione të drejtpërdrejta të shpenzimeve që janë kryer për shërbime specifike sipas marrëveshjes në mes Paditësit dhe kompanisë ame. Lidhur me Zbatimin e Rregullave të TVSH-së: është dhënë mendimi dhe konstatimi se: Paditësi ka argumentuar se ka faturuar konform Nenit 20 Vendi i furnizimit të shërbimit të ligjit për TVSH 05-L /037 respektivisht paragrafit 1 Vendi i furnizimit të shërbimeve për personin e tatueshëm, duhet të jetë vendi ku ky pranues e ka themeluar biznesin e tij. Mirëpo, nëse këto shërbime i ofrohen njësisë fikse të personit të tatueshëm të vendosur në një vend tjetër nga vendi ku ai e ka themeluar biznesin e tij, vendi i furnizimit të këtyre shërbimeve duhet të jete vendi ku është vendosur ajo njësi fikse. Në mungesë të këtij vendi të themelimit ose njësisë fikse, vendi i furnizimit të shërbimeve duhet të jete vendi ku personi i tatueshëm, i cili i pranon këto shërbime, e ka adresën e tij të përhershme ose ku ai zakonisht jeton. Kjo specifikon se furnizimet që kryhen jashtë vendit janë të liruara nga TVSH.*

*Po ashtu jashtë periudhës së kontestuar ka aplikuar një marzhe fitimi për shërbimet e ofruara si dhe ka pranuar pagesa për pjesën me të madhe të faturave, përjashto faturat e muajit të fundit të vitit 2017. 4. Vendimi i Ankesave dhe Procedura Ligjore Departamenti i Ankesave ka refuzuar apelin e Paditesin duke argumentuar se rifaturimet nuk permbajne pershkrim te duhur te sherbimeve dhe se dokumentimi nuk shte bere sipas nenit 25 të UA Nr. 03/2015. Kjo çështje nënkupton një interpretim të ngushtë të ligjit që dhe në këtë rast e paditura nuk merr parasysh të gjitha rrethanat e dokumentacionit të dorëzuar. Konstatimi nëse ka ndodhur furnizimi i mallit apo shërbimit ndaj shoqërisë amë: Sipas dokumentacionit të rishikuar, përfshirë kontratat dhe faturat, ekzistojnë prova të qarta që tregojnë se furnizime të caktuara të mallrave dhe shërbimeve kanë ndodhur drejt kompanisë amë. Këto transaksione janë plotësisht dokumentuar dhe mbështetura nga regjistrat përkatës, të cilët konfirmojnë rrjedhën e tyre të saktë. Për me tepër, Administrata Tatimore ka pranuar nga Padiësi raportin e detajuar për transaksionet e kontrolluara për vitin 2017, i cili ofron një pasqyre shtesë dhe konfirmon zbatimin e rregullave dhe procedurave të duhura tatimore nga ana e padiësit për transaksionet e kontrolluara. Ky raport i plotëson dhe i verifikon të dhënat e paraqitura në dokumentacionin e rishikuar, duke përmirësuar kështu integritetin dhe besueshmërinë e informacioneve të mbledhura për këtë çështje. Konstatimi nëse ka ndodhur konsiderata (pagesa) për furnizimet që padiësi ka kryer ndaj shoqërisë amë: Nga rishikimi i transaksioneve financiare dhe regjistrave bankar, është konstatuar se ka pasur pagesa që shoqëria amë ka kryer për shërbimet e marruara nga padiësi. Këto pagesa janë të dokumentuara dhe përputhen me vlerat dhe kohëzgjatjen e transaksioneve të regjistruara. Konstatimi i fakteve të tjera të rëndësishme për vendosjen e kësaj çështje juridike administrative • Pavarësia e Veprimeve Ekonomike dhe Kontrolli Tatimor - Administrata Tatimore ka vene ne dyshim pavarësinë e veprimeve ekonomike të Padiësit, duke argumentuar se transaksionet dhe faturimet nuk janë kryer në mënyrë të pavarur. Mirëpo padiësi përdor argumentin e Nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015 për Zbatimin e Ligjit për TVSH, i cili sqaron se pavarësia ekonomike nuk është komprometuar nga marrëdhëniet e ndërlidhura të kompanisë. Ky nen siguron një përjashtim për personat që operojnë në mënyrë të pavarur, pavarësisht të hyrave ose marrëdhënieve të ndërlidhura. • Marrëveshja mes palëve, e cila është datuar pas periudhës së kontestit, tregon se parimi i akruales (realizimit) nuk është zbatuar siç duhet. Kjo marrëveshje, e lidhur pas datave që përfshihen në periudhën e kontrollit tatimor, sugjeron një mungesë të regjistrimit të transaksioneve në kohën e tyre të duhur financiare, duke pasur kështu efekte të mundshme në saktësinë e deklaratave tatimore dhe financiare të subjektit. Ndërsa lidhur me plotësimin e ekspertizës financiare të kërkuar nga gjykata me të cilin është obliguar ekspertja që të sqaroj diferencën e dal nga ekspertiza në vlerë prej 34,874.69 euro dhe*

asaj nga raporti i kontrollit që është në shumën prej 39,147.35 euro përfshirë edhe diferencë ndërmjet ekspertizës dhe raportit të kontrollit, është dhënë konstatimi se: *“Pas verifikimit të mëtejshëm dhe komunikimit me palën paditëse, është ri-konfirmuar që TVSH shtesë prej 4, 272.66 euro dhe ndëshkimet prej 1,068.16 euro për muajin maj 2016 nuk janë pjesë e kontestit gjyqësor aktual dhe për pasojë, duhet të përjashtohen nga llogaritjet e ndëshkimeve dhe TVSH-së shtesë në këtë çështje siç është paraqitur në Raportin e ekspertizës së datës 30.04.2024. Duke marr parasysh të dhënat dhe dokumentacionin e rishikuar dhe të dorëzuar, konfirmoj që TVSH shtesë dhe zvogëlim i kreditimit të TVSH-së mbasin në vlerë të njëjtë me raportin e ekspertizës së datës 30.04.2024 në vlerë prej 217,361.24 euro dhe ndëshkimet administrative të lidhura me këtë çështje në janë në vlerë prej 8,153.13 euro.*

Pala e paditur me parashtrësën e datës 09.07.2024 dhe datës 22.08.2024 e ka kundërshtuar ekspertizën financiare dhe plotësimin e saj.

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare të datës 30.04.2024 të ekspertit financiar Blerta Salihu Krasniqi dhe plotësimin e saj të datës 05.08.2024 në tërësi si të besueshme, meqë e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat.

Eksperti financiar në seancën e shqyrtimit gjyqësor – kryesor të datës 26.08.2024 ka deklaruar se: *“Mbes prapa plotësimit të ekspertizës, jam e gatshme për çdo sqarim shtesë nëse është e nevojshme”*.

Gjykata ka konstatuar se paditësi ka paraqitur prova se faturat përmbajnë detaje dhe përmbajnë përshkrim të qartë edhe atë sipas nenit 45 dhe 45 të Ligjit për TVSH-në Nr.05/L-037, i cili parasheh se *“çdo faturë duhet të përmbajë një përshkrim të qartë të mallrave ose shërbimeve”*, dhe po ashtu ka argumentuar se faturat janë jo vetëm për ri-faturime por për transaksione të drejtpërdrejta të shpenzimeve që janë kryer për shërbime specifike sipas marrëveshjes në mes të paditësit dhe kompanisë amë. Po ashtu paditësi ka argumentuar se ka faturuar konform nenit 20 të Ligjit 05/L-037 me të cilin përcaktohet se: *“Vendi i furnizimit të shërbimeve për personin e tatueshëm, duhet të jetë vendi ku personi e ka themeluar biznesin e tij. Mirëpo nëse këto shërbime i ofrohen njësisë fikse të personit të tatueshëm të vendosur në një vend tjetër nga ai vendi ku ai e ka themeluar biznesin e tij, vendi i furnizimit të këtyre shërbimeve duhet të jetë vendi kur është vendosur ajo njësi fikse, vendi i furnizimit të shërbimeve duhet të jetë vendi ku personi i tatueshëm, i cili pranon këto shërbime e ka adresën e tij të përhershëm ose ku ai zakonisht jeton”*,

e që në interpretim të drejtë të kësaj dispozite kjo specifikon se furnizimet e kryera jashtë vendit janë të liruar nga TVSH. Gjithashtu sipas dokumentacionit të rishikuar, përfshirë kontrata dhe faturat, ekzistojnë prova të qarta që tregojnë se furnizime të caktuar të mallrave dhe shërbimeve kanë ndodhur drejtë kompanisë amë, këto transaksione janë plotësisht të dokumentuara dhe të mbështetura nga regjistrat përkatës, të cilat konfirmojnë rrjedhjen e tyre të saktë. Edhe nga rishikimi i transaksioneve financiare dhe regjistrave bankar, është konstatuar se ka pasur pagesa që shoqëria amë ka kryer për shërbimet e marra nga paditësi, këto pagesa janë të dokumentuara dhe përputhen me vlerat dhe kohëzgjatjen e transaksioneve të regjistruara.

Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, Neni 46, paragrafi 1. *“Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim”*, paragrafi 2. *“Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”*. Paragrafi 3. *“Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”*, paragrafi 4. *“Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”*, dhe paragrafi 5. *“Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendos edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”*.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit është plotësisht i bazuar dhe i drejtë dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamjet ligjore, për t'ia kthyer mjetet e paguar më tepër, në shumën prej 217,361.24 euro në emër të TVSH-së shtesë dhe mos njohjes së kreditimit të TVSH-së për periudhën maj 2016-dhjetor 2017 dhe shumën prej 8,153.13 euro në emër të ndëshkimeve dhe interesave, apo shumën e përgjithshme prej 225,514.37 (dyqindën e njëzet e pesë mijë e pesëqind e katërbëdhjetë euro e tredhjet e shtatë cent). Prandaj Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 81, par 2, nën par. 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 46 par.5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit dhe e anuloi vendimin e kontestuar, duke e obliguar të paditurën që paditësit t'ia kthej mjetet e paguara më tepër në shumën e përgjithshme prej 225,514.37 (dyqindën e njëzet e pesë mijë e pesëqind e katërbëdhjetë euro e tridhjetë e shtatë cent), krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.



Sa i përket kamatës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, konform nenit 82 par. 4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është paraparë se “*Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t’i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*”, ndërsa lidhur me datën e rrjedhës së kamatës, është marrë data e pranimit të aktgjykimit e deri në kthimin e plotë.

Gjykata mori parasysh edhe deklaratimet e të paditurës, të dhëna në përgjigjen ndaj padisë dhe parashtrësat me të cilat u kundërshtua ekspertiza financiare dhe plotësimi i saj. Megjithatë, gjykata konstatoi se këto deklaratime nuk kanë ndikim në ndryshimin e vendimit në këtë çështje juridike administrative. Kjo për shkak se pretendimet e paditësit, siç u vlerësua më herët, janë të mbështetura në dokumentacion, i cili gjen përkrahje në dispozitat ligjore të cekura më lart.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, Gjykata konform nenit 43, par 1 dhe 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.226/22 datë 26.08.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.